



Udhëzues Metodologjik

Titulli i projektit: “**Environmental Justice in Albania**” Numri i referencës:
IPA III/2023/452-010

Pozicioni i punës: Ekspert i fushës ligjzbatuese për realizimin e kërkimeve në sektorin policor dhe përgatitjen e Kapitullit “Roli i Policisë në Drejtësinë Mjedisore në Shqipëri”.

Vendndodhja: **Tiranë, Elbasan, Korçë**

Produkti final deri më

Kohëzgjatja: **06/04/2025¹**

Afati I aplikimit: **31/01/2025**

1. Qëllimi i këtij udhëzuesi metodologjik

Mbrojtja e mjedisit mbetet një problem shqetësues pavarësisht vëmendjes së shtuar që po i kushtohet në vitet e fundit. Pritet dhe synohet që ndërgjegjësimi për mbrojtjen e mjedisit i të gjithë aktorëve me ndikim në të, të rritet. Objektivat madhore të projektit “EJA” janë aksesimi në drejtësinë mjedisore në Shqipëri përmes përmirësimit të kapaciteteve juridike dhe atyre ligjzbatuese, si dhe rritjes së pjesëmarrjes publike.

Ky udhëzues metodologjik është hartuar posaçërisht për ekspertin që do të punojë me një hallkë të rëndësishme të sistemit ligjzbatues, atë të policisë. Udhëzuesi përcakton hapat e nevojshëm për të pasur një pamje reale të bazës ligjore mbi të drejtat mjedisore dhe mënyrën se si prokuroritë në Shqipëri e kanë zhvilluar praktikën hetimore në këtë fushë.

Më konkretisht, në konsultim me ekipin e projektit, eksperti do të duhet të ndjekë konsideratat vijuese për realizimin e detyrës:

2. Konsiderata 1: Realizimi i një vështrimi të përgjithshëm

Policia e shtetit, ajo bashkiake dhe IKMT janë autoritetet ligjore fillestare për marrjen e dëgjimit, identifikimin dhe referimin e veprave penale kundër mjedisit. Nëpërmjet këtyre termave të referencës të cilat do të identifikojnë punën e autoriteteve të sipërcituara për gjurmimin, hetimin dhe parandalimin e veprave penale kundër mjedisit, duke u bazuar në rastet konkrete të cilat janë në juridiksionin dhe kompetencën e tyre, do t'i vijmë në ndihmë ekspertëve mjedisorë për të konkretizuar zonat e rrezikut mjedisor.

Veprat penale kundër mjedisit parashikohen nga Kreu IV i Kodit Penal të vitit 1995. Ato përbëjnë një gamë të konsiderueshme kundërvajtjesh penale dhe krimesh me në qendër

¹ Në rast se koha e parashikuar për realizimin e detyrave shihet si e pamjaftueshme nga aplikantët, gjatë aplikimit të tyre ata mund të propozojnë një tjetër kohëzgjatje duke e mbështetur këtë kërkesë me prova dhe një argumentim përshtatës.



mbrojtjen e mjedisit. Në themel të këtyre veprave penale qëndron mbrojtja e ajrit, ujit dhe tokës, pa lënë pa përmendur mbrojtjen e veçantë të florës dhe faunës.

Megjithatë, përveç faktit që vendi ka një kodifikim shumë të mirë, në realitet parandalimi dhe ndjekja e këtyre veprave është shumë e rrallë.

Disa nga këto vepra penale hyjnë në rangun e veprave penale dytësore të cilat kanë raport varësie dhe përbëjnë vepër penale vetëm pasi të jetë konsumuar fakti i kundërvajtjes administrative. Këtu mund të përmendim veprat penale si “Peshkimi i ndaluar”, “Prerja e paligjshme e pyjeve”, “Prerja e pemëve zbukuruese”.

Sa më sipër, shqyrtimi i trajektores së drejtësisë në lidhje me abuzimin mjedisor, duke filluar që në hallkat fillestare, sikurse është policia, do të përmirësojë zbatimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor për mbrojtjen e mjedisit si dhe do të rrisë efektivitetin e agjencive të zbatimit të ligjit në parandalimin e këtyre veprave penale, parandalimin e pasojave dhe rekuperimin e tyre për aq sa është e mundur, në ndihmë të të cilëve vjen edhe hartimi i Termave të Referencës.

3. Konsiderata 2: Përcaktimi i qëllimeve dhe kornizës për kryerjen e analizës diagnostike

Termat e Referencës synojnë të realizojnë qëllimet e mëposhtme në lidhje me përpilimin e raportit investigativ Polici e Shtetit, Polici Bashkiake, Inspektoriat i Kombëtar i Mbrotjes së Territorit (IKMT) dhe institucione të tjera në varësi të ekzekutivit, si vijon:

- Një shqyrtim i veprimtarisë së organeve të policisë të përmendura më sipër, në lidhje me gjurmimin, hetimin dhe parandalimin e krimit mjedisor, ndjekjen penale të veprave penale kundër mjedisit prej vitit 2015;
- Detajimi i etapave se si zhvillohet në praktikë mbrojtja mjedisore nga organet e Policisë së Shtetit, Policisë Bashkiake, IKMT etj.;
- Mbledhja e të dhënave gjithëpërfshirëse;
- Orientimi i punës së ekspertëve investigues në lidhje me mënyrën e mbledhjes së tyre dhe burimet referuese;
- Përcaktimi i indikatorëve për kryerjen e analizës së të dhënave dhe informacioneve të mbledhura;
- Evidentimi i llojeve të krimit mjedisor në territorin e Republikës së Shqipërisë të cilat më së shumti janë në fokus të praktikave të policisë;
- Përcaktimi i qarqeve më problematike;
- Përpilimi i një formulari të mirëstrukturuar për t'u përdorur në rishikimin e teknikave investiguese të përdorura nga organet e policisë;
- Investigimi i rasteve të referuara në media.

4. Konsiderata 3: Kompetencat dhe juridiksioni i policisë në parandalimin dhe luftën kundër krimit mjedisor

Kompetencat dhe juridiksioni i Policisë së Shtetit, Policisë Bashkiake, Inspektoriatit Kombëtar të Mbrotjes së Territorit (IKMT) dhe institucioneve të tjera në varësi të ekzekutivit, kanë për qëllim parandalimin e krimit mjedisor pa kufizim si kundërvajtje ose krime, sinjalizimin dhe kryerjen e hetimeve kur delegohen nga organi i akuzës.

Konkretisht veprimet parandaluese dhe sinjalizuese konsistojnë në:

- Identifikimin e situatave dhe subjekteve përpara se fakti penal të ketë ndodhur ose në momentet fillestare.
- Kryerjen e veprimeve me natyrë teknike por edhe procedurale në përputhje me qëllimin e parashikuar në ligjin organik të secilit prej këtyre institucioneve.
- Kryerjen e veprimtarisë gjurmuese me qëllim identifikimin e subjekteve autorë.
- Mbledhjen dhe grumbullimin e provave.
- Kryerjen e çdo veprimi procedural të deleguar nga organi i akuzës.
- Asistimin e ekspertëve mjedisorë kur kërkohet nga këta të fundit ose nga shoqata, organizata, OJF etj.

5. Konsiderata 4: Periudha kohore e kërkimit

Kërkimi dhe mbledhja e të dhënave sugjerohet të realizohet për periudhën kohore që prej vitit 2015, duke qenë se Policia e Shtetit, Polici Bashkiake, Inspektoriatit Kombëtar i Mbrotjes së Territorit (IKMT) dhe institucione të tjera në varësi të ekzekutivit i janë nënshtruar ndryshimeve ligjore të njëpasnjëshme.

Të dhëna të tjera përpara kësaj periudhe apo përtej përmbajtjes së dokumentave të publikuara mund të kërkohen nëpërmjet shkresave zyrtare bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

6. Konsiderata 5: Kontrolli i punës së policisë

Grupi i investigimit që do të shqyrtojë punën e policisë dhe do të mbledhë të dhëna lidhur me veprimtarinë e këtyre organizmave ekzekutivë në kuadër të parandalimit dhe hetimit të krimit mjedisor, duhet të gjurmtojë të dhëna në lidhje me:

- numrin e rasteve të regjistruara.
- numrin e referimeve që janë bërë për kundërvajtje penale dhe sa për krime.
- numrin e çështjeve të referuara nga shtetasit, institucionet, OJF-të etj.
- numrin e çështjeve në të cilat vepra penale është kryer nga individët, persona fizikë dhe kur është kryer nga personat juridike, përgjegjësia penale e të cilëve rregullohet me ligjin nr. 9754, datë 14.06.2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”. Në kuadrin e personave juridikë duhet të identifikohet nëse janë institucione publike, ndërmarrje shtetërore dhe ente të tjera publike, apo subjekte private, shoqëri tregtare apo ente të tjera private.

- zonat/qarqet ku kryhen shumica e këtyre veprave penale.
- metodat me natyrë teknike – hetimore sipas parashikimeve në ligjin për Policinë e Shtetit, Kodit të Procedurës Penale dhe ligjit për mbrojtjen e territorit dhe mjedisit.
- nëse këto krime janë hetuar me hetime të thjeshta ose me metoda speciale.
- numrin e rasteve ku krimi mjedisor është parandaluar plotësisht ose pjesërisht falë ndërhyrjes së organeve të policisë.

Krimet mjedisore, në kuptim të fillimit të ndjekjes penale janë vepra penale për të cilat autoriteti procedues që shpesh herë është policia e shtetit merr dijeni kryesisht. Në këtë kuptim do të konsiderohet kryesisht çdo rast flagrante, sinjalizimi, informacioni ose lajmërimi me përjashtim të atyre rasteve që kërkojnë kallëzimin ose ankimin si veprim dhe akt procedural në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale dhe që i drejtohen organit të akuzës si autoritet.

Po ashtu dhe Byroja Kombëtare e Hetimit mund të inkuadrohet në këtë ekspertizë duke pasur parasysh të dhëna me interes që mund të kërkohen referuar si më poshtë:

- numrit të veprave kundër mjedisit të cilat janë parandaluar ose ndjekur falë veprimeve të agjentëve të Byrosë Kombëtare të Hetimit.
- faktin nëse ka të regjistruara procedime për veprat penale kundër mjedisit të kryera nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale ose organizata terroriste.
- Raste të gjurmimit të fakteve penale ose autorëve të tyre të mundshëm.

7. Konsiderata 6: Lista e institucioneve referuese për mbledhjen e të dhënave

Në kuadër të luftës kundër krimit mjedisor kompetencat dhe juridiksioni i Policisë së Shtetit janë të parashikuara nga ligji organik por aktorë të rëndësishëm në këtë drejtim janë edhe institucione të tjera dhe agjenci shtetërore, të cilat funksionojnë në bazë të ligjeve me natyrë juridiko-administrative e që kanë për objekt dhe qëllim mbrojtjen mjedisore, parandalimin e këtyre veprave penale, parandalimin e pasojave dhe rekuperimin e tyre për aq sa është e mundur.

Prandaj, në mënyrë që ekspertët investigues të mbledhin informacione të dobishme në lidhje me krimin mjedisor dhe veprimtarinë parandaluese dhe hetimore të policisë dhe agjencive ligjzbatuese, duhet t'i drejtohet institucioneve si më poshtë:

Institucionet	Sfera e veprimtarisë	Tipologjia e veprave
---------------	----------------------	----------------------

<p>Policia e Shtetit</p>	<p>Garantimi i një mjedisi të sigurtë për komunitetin nëpërmjet policimit me standartet më të larta të performancës, krijimit të një kulture bashkëkohore manaxhimi dhe të mbështetur me infrastrukturën më të përparuar</p>	<p>Të gjitha veprat penale të parashikuara nga Seksioni 11, Kreu III dhe Kreu Ivnë tërësi I Kodit Penal.</p>
<p>Policia Bashkiake</p>	<p>Ushtrimi i funksioneve në shërbim të sigurisë, qetësisë dhe rendit në komunitet, mbarëvajtjes së punëve publike, miradministrimit të hapësirave publike dhe mbrojtjes së mjedisit në territorin e juridiksionit të saj.</p>	<p>Të gjitha veprat penale të parashikuara nga Seksioni 11, Kreu III dhe Kreu IV në tërësi i Kodit Penal.</p>
<p>Byroja Kombëtare e Hetimit</p>	<p>Një shërbim i specializuar të policisë gjyqësore që realizon parandalimin, zbulimin, hetimin, dhe goditjen e veprimtarisë kriminale, nëpërmjet hetimit proaktiv, aplikimit të teknikave speciale të hetimit, aplikimit të sistemeve , databazës, analizës dhe inteligjencës, mjeteve të teknologjisë së informacionit si dhe forcimin e masave që</p>	<p>Veprat penale në juridiksionin penal të Prokurorisë së Posaçme, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale, veprat penale kundër mjedisit Kreu VI i Kodit Penal.</p>
	<p>synojnë rritjen e parametrave të sigurisë në vend.</p>	

<p>Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT)</p>	<p>Mbrojtja e territorit dhe e peizazhit nga ndërhyrjet dhe zhvillimet e kundërligjshme, duke garantuar një zhvillim të qëndrueshëm e të sigurt në fushën e zhvillimit, të planifikimit, të mbrojtjes së territorit, të tokës, të ajrit, të ujërave dhe të pyjeve, të disiplinimit të punimeve në ndërtim, të produkteve të ndërtimit, si dhe në fushën e menaxhimit të integruar të burimeve ujore.</p>	<p>Kundërvajtjet administrative sipas nenit 62 të ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar</p> <p>Kundërvajtjet administrative sipas nenit 36 të ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet”, i ndryshuar</p> <p>Kundërvajtjet administrative sipas nenit 67 të ligjit nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, i ndryshuar</p> <p>Kundërvajtjet administrative sipas nenit 6 të ligjit nr. 61/2016 “Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në RSH”</p> <p>Kundërvajtjet administrative sipas nenit 97 të ligjit nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar</p> <p>Kundërvajtjet administrative sipas nenit 69 të ligjit nr. 10 431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar</p> <p>Kundërvajtjet administrative sipas nenit 23 të ligjit nr. 9115, date 24.07.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”</p>
---	--	---

<p>Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM)</p>	<p>Mbrojta e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtja dhe përmirësimi i tij,</p>	<p>Kundërvajtjet administrative në nivel kombëtar sipas nenit 69 të</p>
	<p>parandalimi dhe pakësimi i rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimi dhe përmirësimi i cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimi i kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.</p>	<p>ligjit nr. 10 431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar</p>
<p>Agjencitë Rajonale të Mjedisit</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. ARM Tiranë/Durrës/Dibër 2. ARM Berat/Korçë/Elbasan 	<p>Mbrojta e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtja dhe përmirësimi i tij, parandalimi dhe pakësimi i rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimi dhe përmirësimi i cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimi i kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.</p>	<p>Kundërvajtjet administrative në nivel rajonal sipas nenit 69 të ligjit nr. 10 431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar</p>

<p>të Mbrojtura mbëtare e Zonave (AKZM)</p>	<p>Shpallja, ruajtja, administrimi, menaxhimi, përdorimi i qëndrueshëm i zonave të mbrojtura mjedisore dhe të burimeve të tyre natyrore e biologjike, në bazë të parimit të zhvillimit të qëndrueshëm, për të garantuar përmbushjen e funksioneve mjedisore, ekonomike, sociale e kulturore, në interes të të gjithë shoqërisë, si dhe përcaktimi i përgjegjësive të institucioneve publike dhe personave fizikë/juridikë privatë për ruajtjen dhe administrimin e qëndrueshëm të tyre.</p>	<p>Kundërvajtjet administrative sipas nenit 67 të ligjit nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, i ndryshuar</p>
<p>Agjencia Kombëtare e Bregdetit</p>	<p>Mbrojtja dhe zhvillimi i një mjedisi të qëndrueshëm të zonës bregdetare, nëpërmjet monitorimit dhe kontrollit të të gjithë potencialit ekzistues të zonës</p>	<p>Kundërvajtjet administrative sipas nenit 71 të ligjit nr. 93/2015 “Për turizmin”.</p>
	<p>bregdetare e detare dhe pasurive mjedisore që përfshihen brenda saj, si dhe kontrollin e veprimtarive turistike në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit.</p>	
<p>Agjencia Kombëtare e Pyjeve</p>	<p>Mirëqeverisja e pyjeve në nivel kombëtar, ruajtja dhe zhvillimi i tyre, përdorimi i qëndrueshëm dhe shumëfunksional i burimeve në fondin pyjor kombëtar, si pasuri natyrore me rëndësi kombëtare</p>	<p>Kundërvajtjet administrative sipas nenit 36 të ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet”.</p>

<p>Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU)</p>	<p>Mirëqeverisja e burimeve ujore me qëllim përmbushjen e të gjitha nevojave jetësore, duke mbajtur në vëmendje qëndrueshmërinë e ekosistemeve, duke nxitur konkurrueshmërinë e përdorimeve dhe prioritizimin drejt përfitueshmërisë ekonomike.</p>	<p>Kundërvajtjet administrative sipas nenit 97 të ligjit nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar</p>
---	---	---

8. Konsiderata 7: Metodologjia dhe burimet për ekzaminim

Praktikisht mbledhja e të dhënave mund të kryhet nëpërmjet konsultimit të dokumentave zyrtare të publikuara në faqet zyrtare online të institucioneve përkatëse të fushës duke filluar nga viti 2015.

Përgjithësisht të dhënat përpara vitit 2015 apo përtej përmbajtjes së dokumentave të publikuara, nuk gjenden në formate elektronike, por mund të kërkohen nëpërmjet shkresave zyrtare bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” drejtuar institucioneve që kanë detyrimin ligjor për të mbledhur, administruar ose raportuar të dhëna, statistika dhe informacione të tjera në lidhje me abuzimin mjedisor, si edhe nëpërmjet zhvillimit të intervistave me oficerët e policisë dhe ekspertët e mjedisit lidhur me njohuri të hollësishme mbi proceset hetimore, sfidat praktike dhe kufizimet me të cilat përballen gjatë hetimit të rasteve të abuzimit mjedisor.

Institucionet	Burimet e investigimit	Adresa/Linqe
---------------	------------------------	--------------

<p>Policia e Shtetit</p>	<p>Raporte dhe analiza vjetore Njoftime publike</p>	<p>https://asp.gov.al/ Gjirokastër/Procedohen penalisht 2 shtetas, për krime kundër mjedisit – Policia e Shtetit DVP Berat – Procedohen penalisht 3 shtetas, për krime kundër mjedisit – Policia e Shtetit https://asp.gov.al/dvp-beratprocedohen-penalisht-3shtetas-per-krime-kundermjedisit/ Policia e Shtetit/Vijojnë kontrollet intensive në të gjithë vendin, për parandalimin, evidentimin dhe goditjen e krimeve mjedisore – Policia e Shtetit</p>
<p>Policia Bashkiake</p>	<p>Raporte dhe analiza vjetore Njoftime publike</p>	<p>https://policiabashkiake.al/</p>
<p>Byroja Kombëtare e Hetimit</p>	<p>Dokumente ndryshme të publikuara</p>	<p>https://spak.gov.al/bkh/</p>
<p>Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit</p>	<p>Publikime të ndryshme</p>	<p>https://ikmt.gov.al/</p>
<p>Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM)</p>	<p>Raporte dhe publikime Monitorime Informacione Statistika</p>	<p>https://akm.gov.al/</p>
<p>Agjencitë Rajonale të Mjedisit</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. ARM Tiranë/Durrës/Dibër 2. ARM Berat/Korçë/Elbasan 	<p>Raporte dhe publikime Monitorime Informacione Statistika</p>	<p>http://drmtirane.akm.gov.al/ http://drmberat.akm.gov.al/</p>

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM)	Publikime të ndryshme	https://akzm.gov.al/
Agjencia Kombëtare e Bregdetit	Publikime të ndryshme	https://bregdeti.gov.al/
Agjencia Kombëtare e Pyjeve	Publikime të ndryshme	https://akpyje.gov.al/
Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU)	Publikime të ndryshme	http://ëëë.ambu.gov.al/
Komisariati Dixhital	Publikime të ndryshme	https://mb.gov.al/komisariatidixhital/ Krimet mjedisore denoncohen edhe në Komisaratin Dixhital/Çuçi: 5 rubrika specifike në aplikacion. Mjet në duart e publikut për të raportuar paligjshmërinë në mjedis - Ministria e Brendshme

9. Konsiderata 8: Kriteret për përzgjedhjen e rasteve studimore dhe shembujve të abuzimit mjedisor

Në mënyrë që grupi investigativ të orientohet siç duhet dhe lehtësisht në përzgjedhjen e rasteve studimore mbi abuzimin mjedisor me fokus veprimtarinë investigative të policisë, ekzistojnë disa kritere për t'u referuar.

Si kritere kryesore për përzgjedhjen e fakteve penale dhe shembujve konkretë që lidhen me abuzimin mjedisor kanë të bëjnë me:

- rrezikshmërinë shoqërore
- impaktin mjedisor

- pasojat në shëndetin dhe jetën e njerëzve

Veprat penale që sugjerohet të investigohen nga grupi i ekspertëve referuar kritereve të mësipërme janë si vijon:

- Ndotja e ajrit, ujit dhe tokës
- Transportimi i mbetjeve
- Dëmtimi i habitateve në zonat e mbrojtura mjedisore
- Menaxhimi i mbetjeve
- Dëmtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër
- Materialet bërthamore dhe substancat e rrezikshme
- Aktivitetet e rrezikshme

10. Produktet

Eksperti i ngarkuar me shqyrtimin e këtij udhëzuesi metodologjik do të jetë përgjegjës për ndjekjen e procedurës së përcaktuar në të.

Eksperti do të jetë gjithashtu në konsultim të drejtpërdrejtë me ekipin e projektit për sa i përket aktiviteteve të kryera, ecuresë, draft-produkteve dhe detyrave të tjera përkatëse për t'u përmbushur.

Përveç kësaj, çdo ndryshim në grafikun e zbatimit për shkak të çështjeve të paparashikuara që mund të lindin, do t'i komunikohet ekipit të projektit.

Për sa i përket detyrave raportuese, këto përfshijnë:

- Përgatitjen e një formati raportimi bazuar në detyrat e përcaktuara në këtë qasje metodologjike;
- Raportim periodik në lidhje me përmbushjen e çdo detyre;
- Çdo provë e mbledhur gjatë fazës së kërkimit duhet të ruhet dhe raportohet.

Në lidhje me Raportin “Cap & Gap”:

- Përgatitja e draft-kapitullit të "Cap & Gap"-it, me titull: “Roli i Policisë në Drejtësinë Mjedisore në Shqipëri”;
- Rishikimin e draft-kapitullit të "Cap & Gap"-it, me titull: “Roli i Policisë në Drejtësinë Mjedisore në Shqipëri”, në konsultim me ekipin e projektit;
- Finalizimi i kapitullit.